

VENDIM
Nr. 18/2018

**PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR, SIPAS
LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË”**

Në mbështetje të pikës 8, të nenit 147, të Kushtetutës dhe të pikës 16, të nenit 35, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Të konsiderojë të zgjedhur kandidatët e listës së tretë në bllok për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që ka rezultuar nga hedhja e shortit në nënkomisionin “Për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, si vijon:

- | | |
|---------------------|--------------------------|
| 1. Fatmira Luli | (nga avokatia) |
| 2. Alban Toro | (nga avokatia) |
| 3. Erjon Muharremaj | (nga trupa e pedagogëve) |
| 4. Maksim Qoku | (nga trupa e pedagogëve) |
| 5. Naureda Llagami | (nga shoqëria civile). |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 8.2.2018